



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



DREJTORIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT

Bazuar në nenin 62.3shkronja b) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr. 03/L-040, nenin 8 parag. 3.3 të Rregullores MF – Nr-04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe nenin 59.4 të Statutit të Komunës nr.01-1/298-10 të datës 12 tetor 2009, Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, bënë këtë:

NJOFTIM PUBLIK PËR DËRGIMIN E PROPOZIMEVE PËR ANËTAR TË KOMISIONIT VLERËSUES PËR SUBVENCIONIMIN E ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE

Njftohen përfaqësuesit e Organizatave të Shoqërisë Civile – OJQ-ve se mund t'i dërgojnë propozimet e tyre për plotësimin e Komisionit vlerësues i cili do të ngritët me qëllim të vlerësimit të aplikacioneve të Organizatave të Shoqërisë Civile – OJQ-ve dhe Klubeve Sportive për subvencionim për vitin 2018, të cilët aplikojnë sipas:

- **Thirrjes publike për mbështetje financiare publike për projekte/ programe të organizatave jo-qeveritare në Komunën e Podujevës në fushën e aktiviteteve kulturore dhe rinore, dhe**
- **Thirrjes publike për mbështetje financiare publik ojq-klubet sportive në Komunën e Podujevës në fushën e aktiviteteve sportive**

Për thirrjet e cekura publike do të ngritën dy (2) Komisione Vlerësuese përkatëse.

Në kuadër të secilit Komision do të përfshihen:

- Një përfaqësues nga OJQ-të,
- Një përfaqësues nga shoqëria Civile në cilësinë e ekspertit

Personat e nominuar për Komisionin Vlerësues, ndër të tjera, duhet t'i dorëzojnë; CV e tyre specifikohen përvojat e mëhershme në fushën e zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të projekteve të ndryshme si dhe një Letër Interesim – rekomandim për pjesëmarrje në këtë Komision, ku prezantohen arsyet e nominimit.

Gjithashtu personat e nominuar përgjithësisht duhet të jenë veprimtarë të njohur dhe me reputacion në komunitetin lokal dhe që kanë aftësi të bëjnë vlerësim të paanshëm.

Përzgjedhja përfaqësuesve bëhet nga një Komision ad-hoc i brendshëm të cilin e ngritë Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Propozimet tuaja do të jenë të mirëseardhura dhe dorëzohen në Qendrën e Shërbimit për Qytetarë zyra nr. 14 objekti kryesor i Komunës dhe të njëjtat i drejtohen Drejtorisë së kulturës Rinisë dhe Sportit më së largu deri më 13.04.2018.

Podujevë 04.04.2018



**Drejtore
Donika Sfishta**